



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

AD-GJTHM.nr.2/2023

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur në çështjen disiplinore të ngritur ndaj F.Xh, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtri, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga pala A. A nga fsh.... Komuna e Vushtrrisë, pas vlerësimit të ankesës dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtarit F.Xh i dt.20.03.2023, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 9 par.6 te Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 28.03.2023, merre këtë;

AKTVENDIM

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga pala A.A kundër Gjyqtarit F.Xh, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtri, e regjistruar me numër të lëndës AD-GJTHM.nr.2/2023, dt.17.03.2023.

Arsyetim

Në cilësinë e autoritetit kompetent te Gjykatës Themelore Mitrovicë kam pranuar ankesën me dt.17.03.202, e parashtruar nga pala A.A, e cila ankesë fillimisht është paraqitur prane KGJK dt.07.02.2023, nr 01/114, ankesa është në raport me gjyqtarin F.Xh, gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtri, lidhur me lëndën C.nr.20/14, ku cek se gjyqtari ka bere shkelë ligjore me rastin e vendosjes e gjithashtu edhe Gjykata e Apelit ka vendosur njëjtë, mirëpo Gjykata Supreme i ka ndërpre parregullsitë dhe lënda është kthyer në Gjykatë të Apelit, ku lënda është duke u zvarritur.

Autoriteti kompetent i Gjykatës - Nënkryetari i Gjykatës me shkresën e dt.17.03.2023, i është drejtuar subjektit te hetimit gjyqtarit F.Xh, duke kërkuar një deklarami me shkrim lidhur me ankesën e palës A.A.

Gjyqtari i rastit F.Xh ka dhënë përgjigje-deklaratë me dt.20.03.2023, lidhur me ankesën e A.A, në të cilën cek se nuk ka çka të thotë më tepër se sa që ka thënë në aktgjykimin C.nr.20/14 , i cili aktgjykim është vërtetuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2019/17 të dt.21.09.2020. Pastaj shërbimi i referentëve te kësaj gjykate ka theksuar se rrjedh se pala A.A, ka qenë i gjykuar me aktgjykim të formës së prerë në lëndën

penale P.nr.417/2004 nga Gjykata Themelore në Gjilan për veprën penale Mashtrim nga neni 261 par.1 të Kodit të Përkohshme Penal të Kosovës.

Ka theksuar se të gjitha pretendimet tjera të palës ndaj tij si gjyqtar duke përfshirë edhe Gjykatën e Apelit, kinse se është punuar me të njohshëm, pretendimet se jam i korruptuar janë të pavërteta, le të ofroj prova, ne të kundërtën pretendimet e tilla janë me pasoja ligjore në kuptim të nenit 382 të KPRK-es, nga shkaqet e cekur propozoj që ankesa si e tillë të refuzohet.

Nënkryetari i Gjykatës në cilësinë e autoritetit kompetente sipas Ligjit për Përgjegjësitë disiplinore për Gjyqtare dhe Prokuror, ka vlerësuar ankesën dhe pretendimet e palës së A.A dhe ka gjetur se në ankesë pala vetëm përshkruan pakënaqësitë që i ka shprehur në vendosjen e çështjes.

Andaj, autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkrete të Ligjit për Përgjegjësitë disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror nuk mund të kemi një dyshim të qëndrueshëm për veprime të mëtejme, duke marre për bazë edhe përgjigjen e marre nga gjyqtari ndaj të cilit është ngritur procedura disiplinore, andaj ankesa disiplinore është refuzuar e pabazuar, se çështje e vendosjes lidhur me lëndën i përket gjyqtarit të çështjes, i cili ka vendosur çështjen me aktgjykimin C.nr.20/14, i cili aktgjykim është vërtetuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2019/17 të dt.21.09.2020, tani lënda është për shqyrtim dhe vendosje gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, pasi që Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim ka ndërprerë procedurën lidhur me vendosjen sipas revizionit të paditurve, derisa të vendoset për propozimin e përsëritjes së procedurës pranë Gjykatës së Shkallës së dytë, si e drejte ligjore e secilës pale në shfrytëzimin e mjeteve juridike, si ato të rregullta dhe të jashtëzakonshme, që janë në dispozicion të palëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe pakënaqësitë e palëve të marrja e vendimeve nga ana e Gjykatës si Shkallë Parë dhe e dytë, nuk mund të konsiderohen edhe shkelje disiplinore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, ne mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorët dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
AD-GJTHM.nr.02/2023, dt. 28.03.2023

Nënkryetar i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit të ankesës A.A**
- 3. Gjyqtarit F.Xh**